



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

Në mbështetje të nenit 30, paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligjit për Prokurorin e Shtetit, nenit 57 dhe 58 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nenit 16 dhe 17 të Ligjit për Menaxhimin për Financat Publike dhe Përgjegjësitë, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV

nr. 02/2014

për

Procedurat Për Kompensimin e Mbrojtësve me Shpenzime Publike

I

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1.

Qëllimi

Ky Udhëzim ka për qëllim të përcaktoj kriteret, procedurën dhe lartësinë e kompensimit të avokatëve mbrojtës me shpenzime publike në të gjitha Prokuroritë e Republikës së Kosovës.

Neni 2.

Avokati mbrojtës me shpenzime publike

1. Për qëllime të këtij udhëzimi termi avokat mbrojtës me shpenzime publike nënkupton avokatin e regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës, i cili është:
 - 1.1. Emëruar sipas detyrës zyrtare nga prokuroria për të mbrojtur të pandehurin në rast të mbrojtjes së detyrueshme sipas Kodit të Procedurës Penale; ose
 - 1.2. Emëruar nga Prokuroria me kërkesë të të pandehurit sipas të Kodit të Procedurës Penale, nëse nuk janë plotësuar kushtet e mbrojtjes së detyrueshme;

Neni 3.
Kompensimi i avokatit mbrojtës me shpenzime publike

1 Avokati mbrojtës me shpenzime publike do të kompensohet për:

- 1.1. Shqyrtimin e shkresave;
- 1.2. Mbrojtjen e të pandehurit sipa kërkesave të Prokurorit;

II.
Kompensimi për shërbimet e Avokatit mbrojtës

Neni 4.
Shqyrtimi i shkresave

1. Për shqyrtimin e shkresave në Departamentin e Përgjithshëm avokati mbrojtës me shpenzimet publike i takon kompensimi në vlerë prej **10 €**.
2. Për shqyrtimin e shkresave në Departamentin për Krime të Rënda dhe në Departamentin për të Mitur, avokatit mbrojtës me shpenzimet publike i takon kompensimi në vlerë prej **20 €**.
3. Për shqyrtimin e shkresave, mbrojtësi kompensohet vetëm një here.
4. Në rast të shqyrtimit të shkresave plotësuese për një rast konkret, mbrojtësi mund të kompenzohet edhe një here shtesë.
5. Mbrojtësi nuk mund të kompenzohet me shumë se dy here për shqyrtimin e shkresave për një rast konkret.

Neni 5.
Mbrojtja e të pandehurit

1. Për mbrojtjen e të pandehurit në seancë në Departamentin e Përgjithshëm, sipas kërkesës së Prokurorit, avokatit mbrojtës me shpenzime publike i takon kompensimi si në vijim:
 - a. për veprë penale për të cilën parashihet dënimi deri në tri vite burg, shuma prej **40 €**;
 - b. për veprë penale për të cilën parashihet dënimi deri në pesë vite burg, shuma prej **48 €**;
 - c. për veprë penale për të cilën parashihet dënimi deri në dhjetë vite burg, shuma prej **68 €**;
 - d. për vepra penale të krimit të organizuar, shuma prej **127,50 €**;
 - e. për veprë penale për të cilën parashihet dënimi mbi 10 vite burg, shuma prej **150 €**;
2. Për mbrojtjen e të pandehurit në seancë në Departamentin për Krime të Rënda dhe të miturit sipas kërkesës së Prokurorit, Mbrojtësit sipas detyrës i takon kompensimi në shumë prej **80 €**, për veprë për të cilën parashihet dënimi mbi dhjetë vite burg.

3. Për mbrojtjen e të pandehurit në seancën që zgjatë më shumë se një (1) orë, sipas kërkeses së Prokurorit, Avokatit mbrojtës me shpenzimet publike i takon kompensimi plotësues.
4. Për çdo orë shtesë të prezencës në seancë, sipas kërkeses së Prokurorit, avokatit mbrojtës me shpenzimet publike i takon + **30%** e kompensimit të përcaktuar me nën paragrafët a., b., c., d. dhe e.

Neni 6. Limiti i Kompensimit

Kompensimi i avokatit mbrojtës me shpenzime publike nuk mund të tejkaloj shumë prej **500.00 €** (Pesëqind euro) për një muaj kalendarik duke përfshirë angazhimin e tyre në të gjitha Prokuroritë e Republikës Kosovës.

III. Procedura për Kompensimin e avokatit mbrojtës

Neni 7. Avokati mbrojtës i angazhuar me shpenzime publike

1. Avokati mbrojtës me shpenzime publike i angazhuar për herë të parë është i obliguar që në Prokurori të dorëzojë këto dokumente:
 - 1.1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe të Avokatisë;
 - 1.2. Certifikatën e numrit fiskal;
 - 1.3. Kopjen e llogarisë bankare në emër të biznesit/Avokaturës;
 - 1.4. Kopjen e letërnjoftimit;
 - 1.5. Kopjen e kartelës identifikuese valide të lëshuar nga OAK.

Neni 8. Formulari për Kompensim

1. Pas përfundimit të seancës prokurori i rastit është i obliguar që të plotësoj formularin për kompensimin e avokatit mbrojtës me shpenzime publike.
2. Formulari për kompensim duhet të nënshkruhet nga prokurori i rastit dhe Kryeprokurori i Prokurorisë perkatese.
3. Në Formularin për kompensim është e domosdoshme që pranë nënshkrimit të jetë i shënuar emri dhe mbiemri i prokurorit të rastit dhe Kryeprokurorit të prokurorisë perkatese.

Neni 9. Fatura

- 9.1. Fatura duhet t'i përmbajë këto të dhëna:
 - 1.1. numrin e faturës;
 - 1.2. datën e faturës;
 - 1.3. emrin e lëshuesit të faturës (emri i biznesit/avokaturës);

- 1.4. numrin e llogarisë bankare në emër të avokaturës-biznesit;
- 1.5. numrin fiskal të biznesit;
- 1.6. emrin e prokurorisë dhe departamentit perkates;
- 1.7. specifikacionin sipas numrit të lëndës;

9.2. Fatura që të jetë valide duhet të jetë:

- 2.1. e nënshkruar dhe vulosur, me ngjyre të kaltër (vula duhet të jetë në emër avokaturës /biznesit);
- 2.2. e pastër dhe jo e përmirësuar.

Neni 10. Procedura për realizimin e kompensimit

1. Formularin për kompensim të plotësuar dhe të nënshkruar sipas paragrafëve 9.1 dhe 9.2 dhe Faturën valide me të dhënat sipas paragrafit 10.1 dhe 10.2 avokati mbrojtës meshpenzime publike;
 - 1.1. e dorëzon te administratori i prokurorisë apo Zyrtari Financiar i prokurorisë;
 - 1.2. dorëzimi i dokumentacionit për muajin paraprak detyrimisht bëhet nga data 01 (një) deri me 05 (pesë) të muajit vijues;
 - 1.3. përjashtimisht në rrethana të jashtëzakonshme nuk i përmbahet afateve nga pika II e këtij neni për dorëzimin e dokumentacionit për muajin paraprak, pagesa mund të realizohet me arsyetim nga avokati mbrojtës dhe aprovim nga kryeprokurori i prokurorisë perkatese.
2. Administratori apo Zyrtari Financiar i prokurorisë perkatese pas kontrollimit dhe verifikimit të të dhënave, përgatitë tabelën përmbledhëse cila nënshkruhet nga Kryeprokurori i prokurorisë perkatese dhe Administratori/ dhe të njëjtën zyrtari i financave tabelën përmbledhëse dhe dokumentacionin përcjellëse dorëzon sipas paragrafit si më poshtë:
 - 2.1. dorëzon në SKPK-Zyra për Buxhet dhe Financa,
 - 2.2. dorëzimi i tabelës me dokumentacionin e nevojshëm për muajin paraprak bëhet deri më datën 10 të muajit vijues.

Neni 11. Zbatimi

1. Për zbatimin e drejt dhe efikas të këtij Udhëzimi Administrativ me mbështetjen e Zyres për Buxhet dhe Financa të SKPK-së, do të përkujdesen Administratori, Zyrtari Financiar i Prokurorisë perkatese.
2. Avokatet mbrojtës me shpenzime publike nga prokurorët përcaktohen sipas renditjes, të cilën të cilën e përcakton OAK.
3. Shpenzimet e angazhimit të avokatit mbrojtës me shpenzime publike në Polici do të i paguhen nga Prokuroria e cila mbikqyrë atë hetim policor.

Neni 12.
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial të Kosovës, dhe ka karakter retroaktiv nga data 1 gusht 2014.

Prishtinë,

Më datë 04. 11. 2014

Sylë Hoxha,
Kryetar
Këshilli Prokurorial i Kosovës

